



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

26 janar 2017, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA
Institucionet konfirmojnë barrierat për PAK-të, zotohen për eliminimin e tyre**

EC Ma Ndryshe dhe OPDMK të enjten kanë organizuar konferencën “Një qytet pa pengesa”, me ç’rast është diskutuar për barrierat e shumta me të cilat përballen Personat me Aftësi të Kufizuara në përditshmërinë e tyre në Prizren, por edhe komunat e rajonit.

Në kuadër të diskutimeve është theksuar se Personat me Aftësi të Kufizuara në Kosovë në përgjithësi, dhe në Prizren në veçanti, përballen me diskriminimin shumëdimensional në baza ditore, pasi sfidat në qasjen në objekte e transport publik, shëndetësi, arsim, punësim, etj. për këtë komunitet paraqesin pengesë në drejtim të gëzimit të drejtave të garantuara kushtetuese e ligjore, dhe rrjedhimisht të kenë mundësi të barabarta.

Gjatë kësaj konference janë prezantuar të gjitha produktet dhe rezultatet e projektit “Prizreni, një qytet pa pengesa”, të realizuara gjatë vitit 2016. Me këtë rast është bërë publikimi i hulumtimit “Prizreni – Qytet që nuk i ka mënjanuar barrierat për PAK” dhe raporti “Harta e Barrierave në Prizren”.

Në panel kanë prezantuar edhe zyrtarë të Institucionit të Avokatit të Popullit, që kanë paraqitur të gjeturat e tyre në lidhje me çështjen e barrierave për PAK në nivel vendi, duke konfirmuar situatën e palakmueshme në këtë drejtim.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin përfaqësues të institucioneve të zbatimit të ligjit, qeverisë lokale dhe qendrore, organizatave të shoqërisë civile, grupeve të komunitetit, komunitetit profesionist, organizatave ndërkombëtare në Kosovë si dhe medias lokale dhe qendrore. Zyrtarë të institucioneve lokale e qendrore kanë shprehur gatishmërinë që me një qasje gjithëpërfshirëse të ndërmerren veprime konkrete për eliminimin e barrierave aktuale për PAK-të në objektet e hapësirat publike.

Konferenca e organizuar ka qenë aktivitet përmblyllës i projektit “Prizreni, një qytet pa pengesa”. Qëllimi i përgjithshëm i projektit përfshinë ngritjen e pjesëmarrjes së PAK dhe të rinjve në projektimin e Prizrenit pa pengesa.

Projekti “Prizreni, një qytet pa pengesa” përkrahët financiarisht nga USAID nga programi E4E, dhe mbikëqyret nga ATRC dhe implementohet nga EC Ma Ndryshe dhe OPDMK.

Me respekt,

Valon Xhabali, Koordinator Programi
OJQ EC Ma Ndryshe
Saraqët 5, 20000 Prizren

Bulevardi Nëna Terezë 30B H-I-.5, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771

*Ky aktivitet realizohet në kuadër të projektit **Prizreni**, një qytet pa pengesa, që përkrahët financiarisht nga USAID, programi E4E dhe mbikëqyret nga ATRC.*



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

